



---

## Plani i Inspektimeve 2020

### Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut

**Numri total i inspektimeve që do të kryejnë ISHMT për vitin 2020 është 4240 inspektime nga të cilat 845 pa planifikim dhe 3395 me planifikim.**

#### **Drejtoria e Mbikëqyrjes së Produkteve (DMP)**

Referuar metodologjisë së IQ numri total i inspektimeve që do të kryejnë DMP për vitin 2020 rezulton **3312 inspektime** në vit nga të cilat **662 janë të paplanifikuara dhe 2650 inspektime me planifikim**. Megjithatë ky numër inspektimesh është llogaritur duke mos marrë në konsideratë disa faktorë si:

- ISHMT funksionon pa zyra Rajonale, por si Drejtori Qendror.
- Inspektimet mund të jenë më të gjata se 4 orë sepse në disa raste verifikimet dokumentare, verifikimet në publikimet zyrtare të Komisionit Europian (NANDO dhe EA apo ILAC), si dhe kontrolli nëpërmjet provave laboratorike kërkon kohë të konsiderueshme (provat që merren, procedura e mostërmarrjes, sekretimi i mostrës dhe dokumentimi i saj, etj).

Fushat kryesore në të cilat DMP planifikon të ndërmarrë inspektime për vitin 2020 janë:

- Inspektimi i ashensorëve të vendosur përherë të parë në treg dhe në përdorim;
- Inspektimi i Makinerive;
- Inspektimi i instrumentave matës të vendosur në treg dhe në përdorim;
- Inspektimi i Lodrave;
- Inspektimi i Detergjentëve;
- Inspektimi mbi bazën e Ligjit për Mbrojtjen e Konsumatorit ;
- Inspektimi për zbatimin e kërkesave ligjore sipas legjislacionit për sigurinë e përgjithshme dhe legjislacionin në fuqi për kimikatet e rrezikshme në artikuj ( lodrat në sheshe, tekstile, veshjet e fëmijëve, artikuj të kujdesit etj.).

#### **Drejtoria e Pronësisë Industriale dhe Intelektuale (DPII)**

Referuar metodologjisë së IQ, numri total i inspektimeve që duhet të kryhen nga DPII rezulton 1932, por duke patur në konsiderat faktorët si më poshtë renditur numri total i inspektimeve që do të kryhen nga DPII do të jenë **928 inspektime nga të cilët 183 pa planifikim dhe 745 me planifikim**.

Përsa i përket *Sektorit të Drejtav të Autorit* **do të kryhen 828 inspektime** (25% me pak se numri i inspektimeve që del nga metodologjia e IQ) . Ulja e numrit të inspektimeve është bërë duke patur në konsideratë:

- ISHMT funksion si Drejtori Qendrore por mbulon gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe Sektori i të drejtës së Autorit ka në strukturën e tij vetëm 9 inspektorë;
- Mungesave në logjistikë (numri shumë i kufizuar i mjeteve të transportit);
- Shumica e subjekteve që inspektohen nga ky sektor kryhen pa njoftim bazuar në nenin 32 pika 2 e ligjit 10433. Për këtë arsye në shumë raste ka vonesa në kontaktimin e përfaqësuesve të autorizuar të subjekteve.
- Kategoritë e subjeteve si Shtëpi Botuese, përdorues të programeve kompjuterike , përdorues të veprave audio-vizuale (p.sh. OSHMA) kërkojnë shumë kohë në inspektim duke qenë se kanë informacion të gjerë dhe të shumtë në ambientet e tyre tregtare.
- Problemet e ndeshura gjatë viteve të mëparshme me mosgjetjen e subjekteve në adresat që kanë deklaruar në QKB ose ndryshimet e statusit ose të fushë veprimtarisë.

Përsa i përket *Sektorit të Pronësisë Industriale* nuk mund të planifikohen inspektimet sipas metodologjisë së IQ pasi referuar Ligjit 9947, datë 7.7.2008 “Për Pronësinë Industriale” , institucioni mund të kryejë inspektime vetëm në bazë ankese dhe ex officio. Për vitin 2020 **parashikohet një numër prej 100 inspektimesh të paplanifikuara**, numër që mund të ndryshojë në varësi të ankesave të ardhura nga mbajtësit e të drejtave apo përfaqësuesit ligjor.

Fushat e kryesore në të cilat DMP planifikon të ndërmarri inspektime për vitin 2020 janë:

- Inspektimi i programeve kompjuterike
- Inspektimi i veprave audio-vizuale
- Inspektimi i veprave letrare (shtëpi botuese, fotokopje, shtypshkonjë, etj)

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin,

Nr.	ISHMT	Orët që duhen për një inspektim (orë )	Ditë vjetore të inspektimit për një inspektor (ditë )	Orët vjetore të inspektimit për një inspektor (orë )	Numri total i inspektorëve	Numrin e inspektorëve në grup	Numri I grupeve të inspektimit	Numri i inspektimeve në 1 ditë	Totali i inspektimeve sipas Metodologjisë IQ	Totali inspektime që do të kryehn nga ISHMT	Përqindja e inspektimeve të pa planifikuara (%)	Totali i Inspektimeve të paplanifikuara	Totali i Inspektimeve të planifikuara
<b>1</b>	<b>Drejtoria e Produkteve Joushqimore</b>	<b>4</b>	<b>138</b>	<b>552</b>	<b>25</b>	<b>2</b>	<b>12</b>	<b>2</b>	<b>3312</b>	<b>3312</b>	<b>20</b>	<b>662</b>	<b>2650</b>
1.1	Sektori i Produkteve mekanike	4	138	552	4	2	2	2	552	552	20	110	442
1.2	Sektori i Produkteve Elektrike	4	138	552	4	2	2	2	552	552	20	110	442
1.3	Sektori i qelqit, këpucëve, detergjenteve/sigurisë së produkteve	4	138	552	5	2	2	2	552	552	20	110	442
1.4	Sektori i Inspektimit Metrologjik	4	138	552	12	2	6	2	1656	1656	20	331	1325
<b>2</b>	<b>Drejtoria e Pronësisë Intelektuale dhe Industriale</b>	<b>4</b>	<b>138</b>	<b>552</b>	<b>14</b>	<b>2</b>	<b>7</b>	<b>2</b>	<b>1932</b>	<b>928</b>	<b>20</b>	<b>183*</b>	<b>745</b>
2.1	Sektor i Pronësisë Industriale	4	138	552	6	2	3	2	828	100	0	100*	0
2.2	Sektori i të Drejtës së Autorit	4	138	552	8	2	4	2	1104	828	10	83	745
	<b>TOTALI</b>				<b>39</b>		<b>19</b>		<b>5244</b>	<b>4240</b>		<b>845</b>	<b>3395</b>

\*: Për Sektorin e Pronësisë Industriale në Drejtorinë e Pronësisë Intelektual 100 inpektimet janë të paplanifikuara sepse ky sektor kryen inspektime vetëm mbi bazë ankese. Sektori i te drejtës se autorit do te kryeje 828 inspktime dhe te paplanifikuara ka llogaritur vetem 10% jo 20% .

